LIGJ
Nr. 56/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "LINJA UNAZORE 110 KV E SHQIPËRISË SË JUGUT", NËPËRMJET NJË HUAJE 37 750 000 EURO

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 KV e Shqipërisë së Jugut", nëpërmjet një huaje në vlerën 37 750 000 euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.5.2014

Shpallur me dekretin nr. 8591, datë 13.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankegruppe, Postfach 111141, 60046 Frankfurt am Maim
Faks: (+355) 4 2225581
Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST)
Buleverdi "Gjergj Fishta", nr. 10
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Faks: (+355) 4 222 8494
Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë, Shqipëri

NDRYSHIMI
I MARRËVESHJES SË HUAS NR. 24425
PËR SHUMËN PREJ 37.75 MILIONË EURO
NDËRMJET KFW DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE OST E DATËS 28 DHJETOR 2009-LINJA UNAZORE 110 KV E SHQIPËRISË JUGORE

Datë: 7.2.2014
Zona e Biznesit
KfW
f.ntwicfungsbank

Stefan Krus
Our ref: KSt
Tel: +49 69 7431-3674
Faks: +49 69 7431-2004
stefan.krus@kfw.de

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj letre i referohemi Marrëveshjes së Huas për shumën 37.75 milionë euro (Marrëveshja e Huas) e nënshkruar më 28 dhjetor 2009 ndërmjet KfW-së si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës dhe OST-së si Agjencia e Zbatimit të Projektit. Nëse palët nuk vendosin ndryshe, pikat e përcaktuara në këtë Marrëveshje Huaje kanë të njëjtin kuptim në këtë letër.

Marrëveshja e Huas do të ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2 "Afatet për kërkesën e disbursimit" do të zëvendësohet si më poshtë:

"KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30.6.2016.".

Neni 6.1 "Skeduli i ripagesave" do të zëvendësohet si më poshtë: "Humarrësi do të shlyejë huanë", si më poshtë:

Kësti	Data	Viti	Shuma	Euro
1	dhjetor 30	2016	2,220,588.00	euro
2	qershor 30	2017	2,220,588.00	euro
3	dhjetor 30	2017	2,220,588.00	euro
4	qershor 30	2018	2,220,588.00	euro
5	dhjetor 30	2018	2,220,588.00	euro
6	qershor 30	2019	2,220,588.00	euro
7	dhjetor 30	2019	2,220,588.00	euro
8	qershor 30	2020	2,220,588.00	euro
9	dhjetor 30	2020	2,220,588.00	euro
10	qershor 30	2021	2,220,588.00	euro
11	dhjetor 30	2021	2,220,588.00	euro
12	qershor 30	2022	2,220,588.00	euro
13	dhjetor 30	2022	2,220,588.00	euro
14	qershor 30	2023	2,220,589.00	euro
15	dhjetor 30	2023	2,220,589.00	euro
16	qershor 30	2024	2,220,589.00	euro
17	dhjetor 30	2024	2,220,589.00	euro

Aneksi 1 "Skeduli i disbursimeve" do të zëvendësohet si më poshtë:

"Në fund të çdo periudhe të shënuar më poshtë, Huamarrësi duhet të ketë kërkuar disbursimin e shumave të huas, të cilat nuk do të tejkalojnë shumat e shënuara më poshtë për çdo periudhë:

Të gjitha shifrat në euro	Të disbursuara në	Të disbursuara në	Disbursimet totale

	periudhën aktuale	**periudhat e mëparshme**	
01.01.2014-30.06.2014	11,800,000.00	5,715,406.27	17,515,406.27
01.07.2014-31.12.2014	11.300.000.00	17,515,406.27	28,815,406.27
01.01.2015-30.06.2015	2.350.000.00	28,815,406.27	31,165,406.27
01.07.2015-31.12.2015	2.350.000.000	31,165,406.27	33,515,406.27
01.01.2016-30.06.2016	4.234,593.73	33,515,406.27	37,750,000.00

Me nënshkrimin e kësaj letre ndryshimi dhe duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit përsërisin përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara në nenin 13.1 të Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të Marrëveshjes së Huas dhe nuk përbën një dokument të heqjes dorë në lidhje me ndonjë nga të drejtat tona që rrjedhin nga Marrëveshja e Huas.

Kjo letër rregullohet nga ligji gjerman.

Lutemi jepni konfirmimin tuaj për termat dhe kushtet e kësaj letre, duke nënshkruar ku tregohet më poshtë dhe duke i kthyer një letër origjinale KfW-së.

Me respekt
KfW

Stefan Boltz Stefan Krus

Në kopje
Ne jemi dakord me çështjet e ngritura në letrën tuaj të datës 7 shkurt 2014, e cila është në kopje.

Për dhe në emër të OST-së Datë:

Emri:

Titulli: